



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:228311

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06211996

K.DH.SHK.II.nr.1745/24

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryetar, krenar Berisha dhe Faton Bajrami anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Magic Ice J.S.C. me NUI 810379471 me seli në Prishtinë, te cilin e përfaqëson avokati Florim Shefqeti, kundër të paditurit Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve-Inspektorati i Punës, me seli ne Prishtinë, me bazë juridike, anulimi i aktvendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurës nr. IP nr. 248/24, te dt. 30.07.2024, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit-paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Administrative, nr. KA.nr.404/24 të datës 22.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues Magic Ice J.S.C. me NUI 810379471 me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës se Parë – Departamenti për Çështje administrative, KA.nr.404/24 të datës 22.08.2024, **VËRTETOHET**

A R S Y E T I M

Me aktvendimin e ankimuar të gjykatës se shkalles e pare nr. KA.nr.404/24 të datës 22.08.2024, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit-propozuesit Magic Ice JSC me NUI 810379471 për caktimin e masës së përkohshme-pezullimin e ekzekutimit të vendimit të paditurës nr. IP nr. nr. 248/24, te dt. 30.07.2024, derisa në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, sipas padisë së paditësit.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi-propozuesi, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me

propozim që gjykata të aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshohet aktvendimi i gjykatës komerciale në Kosovë KA.nr.404/24 të datës 22 dhe shtyrjen e ekzekutimit te vendimit te paditurës nr. 248/24, te dt. 30.07.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 194 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-se, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurës, nr. IP nr. 248/24, te dt. 30.07.2024, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi, nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të paditurit, i njëjti do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par. 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon që të ndalohet ekzekutimi i aktvendimit nr. IP nr. 102/24, te dt. 26.03.2024, derisa në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, sipas padisë së paditësit.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, të cekura më gjerësisht si në ankesë, ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se te njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit, është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së, sepse,

kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Administrative në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të nr. IP nr. nr. 248/24, te dt. 30.07.2024, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së,u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SHK.II.nr.1745/24 me datë 25.09.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi